

Shpresoj shumë që kërkesa për miratimin e ndryshimeve në ligjin nr. 8417, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, për zgjatjen e afateve të vetingut, të jetë një hap inkurajues për drejtësinë, pasi qytetarët presin më shumë nga të gjithë aktorët e drejtësisë dhe ne si ligjvënës kemi përgjegjësi përpara tyre. Në fakt, ky moment përkon me dënimin me burg të 2 ish - ministrave të qeverisë Rama për akte korrupsioni dhe lidhje me krimin e organizuar, që janë shumë pak krahasuar me dështimet dramatike të kësaj qeverie, përfshirjen në korrupsion dhe bashkëpunimin me krimin. Aferat që janë denoncuar dhe po denoncohen çdo ditë nga Partia Demokratike janë të rënda dhe reagimi i drejtësisë për këto raste është shumë i ngadaltë. Shoqëria jonë kërkon një pastrim themelor të politikës nga fenomenet e korrupsionit dhe krimin. Për këtë s'ka asnjë dyshim dhe shqiptarët në këtë pikë janë të gjithë në një mendje. Vetingu në politikë, reforma territoriale dhe reforma zgjedhore janë çështje që vijnë si nevojë e kohës.

Në Këshillin e Legjislacionit ka filluar tashmë diskutimi për këto çështje, si një propozim i Partisë Demokratike. Kujtoj se është pikërisht Partia Demokratike ajo që propozoi disa vite me parë ligjin e dekriminalizimit, për të cilin pati shumë mosbesim tek aktorët e Edi Ramës, por që përballë kërkesës së opozitës dhe presionit të faktorit ndërkombëtarë u detyruan ta miratojnë kuadrin ligjor. Falë kësaj iniciative dolën jashtë këtij Kuvendit dhe zyrave të shtetit mbi 300 persona me të kaluar kriminale, që i kemi pasur në këtë Kuvend si modelin më të shëmtuar përballë çdo shqiptari të ndershëm. Ndërkohë, sot vazhdojnë të jenë këtu përfaqësuesit e tyre, të cilët trafikojnë influenca kriminale në territor dhe në proceset zgjedhore. Të gjitha raportet ndërkombëtare, të Departamentit të Shtetit, të institucioneve të Bashkimit Europian apo të organizatave të pavarura, e vendosin theksin në çështjet e korrupsionit dhe lidhjet e politikës me krimin në Shqipëri. Janë këto fenomene të rënda që i varfërojnë shqiptarët, rrënojnë ekonominë, nxisin emigracionin, vrasin besimin dhe shpresën. Çdo ditë në Shkodër ikin në emigracion familje të tëra, qytetarë, njerëz të arsimuar. Ata nuk kanë të ardhme dinjitoze, sepse zyrat e shtetit i kanë zënë pazarxhinjtë. Për të marrë shërbime publike duhet të paguajnë ryshfet apo t'i përuken ndokujt. Ata ikin, sepse nuk duan të rrisin fëmijë të përbuzur dhe pa dinjitet në një vend që ka marrë fytyrën e oborrit të korrumpuar të qeverisë. Shteti është kapur nga paligjshmëria.

E vetmja rrugë për të kthyer besimin është shkëputja e lidhjeve të politikës me krimin. Ne nuk mund të votojmë vetëm për veting në drejtësi, veting në polici, veting në noteri dhe ndërkohë t'i shmangemi procesit të pastrimit të zyrtarëve të lartë, duke nisur nga ky parlament. Ne nuk mund të vazhdojmë të dëgjojmë këtu të bëhet moral për qeverisje të drejtë dhe në darkë të shikojmë politikanët ta ngrysin me botën e krimin për pazare të pista. Qëllimi i procesit të vetingut në politikë është vlerësuar edhe nga Komisioni i Venecias, si qëllim i legjitimuar në kushtet e parandalimit dhe të luftimit të korrupsionit në vend. Me ndryshimet që do të miratohen sot nga ky parlament padyshim që thellohet fryma që po krijon Kushtetuta në betejën ndaj korrupsionit, si rezultat i masave që po zbatohen veçanërisht në kuadrin e reformës në drejtësi. Ndëshkimi i korrupsionit dhe krimin duhet të vazhdojë pa u ndalur nga drejtësia dhe jashtë ndikimeve politike dhe qeverisëse. Vetingu në politikë do të jetë procesi final që do të kthejë besimin te parlamenti, te politika dhe te qeverisjet, do të hapë rrugën që të ketë vërtet njerëz që u shërbejnë qytetarëve e jo padronë të lirisë së shqiptarëve. Faleminderit!